

SPECIFIKIME TEKNIKE

Projekti i rehabilitimit te rruges se fshatit Rrostej, Njesia Administrative Sinaballaj, Rrogozhine

Rruga e fshatit “ Rrostej ” (Sinaballaj)

I. Paraqitje

Ky 'Specifikim Teknik', si dokument kontraktual, është hartuar enkas nga grupi i projektimit për projektin "Rehabilitimi i rruges së fshatit Rrostej. Zërat e rradhitura në përmbajtje, janë pjesë dhe përshkrime të detajuara të vizatimeve të bera nga projektuesit. Standartet e përdorura në këtë 'Specifikim Teknik', nuk kanë qenë mbështetur vetëm në vizatimet por dhe në manualët ligjorë dhe libra të tjera këshillues si:

- Manuali nr.1 i "Analizat Teknike për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere"

Tiranë - Dhjetor 1992 (Republika e Shqipërisë - Ministria e Ndërtimit),

Projektimi i Betoneve të Zakonshme, K.T. 37-75,

Tiranë - 1980 (Republika e Shqipërisë - Ministria e Ndërtimeve I.S.P.Nr. 1).

Raportet e mëposhtme për betonin, përdorur në punimet e ndërtimit dhe referuar zerave specifike, janë të vleshme për 1(një) m³ volum beton me çimento të zakonshme Portland. Këto standarte bazohen në broshurën "Projektimi i Betoneve të Zakonshme, K.T. 37-75",

Tiranë 1980 (Republika e Shqipërisë - Ministria e Ndërtimeve I.S.P.Nr. 1)

II. Betoni

I.a. Punime betoni e beton/armeje

I.a.1 Beton marka 100 me *zhavorr natyror*: Çimento 240kg m³ 400 , zhavorr m³ 1,05 , ujë m³ 0,19 .

I.a.5 Beton marka 250 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg m³ 370 , rërë e lare m³ 0,43, granil m³ 0,69 , ujë m³ 0,185

Transportët

Ngarkim dhe transport me shkarkim në tokë , me çfarëdo mjeti, të materialit që rezultojnë nga Gërmimet, prishjet etj., të çfarëdo natyre dhe lloji, edhe n.q.s. është i lagur, për largimin e tyre nga kantieri në çfarëdo distance dhe niveli, duke përfshirë shkarkimin dhe rrafshimin nëse është i nevojshëm.

punime ne rruge

Gërmim dheu kasonete

Gërmim dheu për trupin e rruges, deri në thellesinë 55cm, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të thate ose të lagur (argjile edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gure etj.), përfshirë prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trugjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m³, plotësimin e detyrimeve në lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave të zeza, të bardha ujësjetës, të elektrikut në përgjithësi etj.,

Shtrese cakulli makinerie, 10, gran.5/60

mm

Ky ze përfshin teresinë e punimeve që lidhen me shtresën e cakullit 10 cm me qëllim përforcimin e trupit të rruges, në drejtimin tërthor dhe gjatësor sipas profileve perkatese të projektit si dhe rulimin dhe ngjeshjen e shtresës së cakullit deri në densitet 95%. Për shkak të gjendjes jo uniforme të sipërfaqes egzistuese të rruges. Në tërë sipërfaqen është parashikuar përdorimi i grejderit me qëllim përpunimin me të mirë të sipërfaqes së rruges dhe rulimi i shtresës me rul 10- 12 ton me 5-6 kalime vajtje ardhje. Granulometria duhet të jetë jo më shumë se 10-15 mm, cakulli që do të përdoret duhet të miratohet paraprakisht me shkrim nga përfaqësuesi i Investitorit dhe Supervizori. Ky material duhet të plotësojë kushtet teknike për qëllimin e përdorimit dhe të mos ketë më shumë se 5% argjila. Ky cmim i referohet 1 m².

Kanalizimet

Gërmim për kanalet

Me zerin nënkuptojmë gërmimin e seksionit të kanalit në thellesinë e kërkuar në projekt, me krahe apo makineri, sipas rastit, përfshi këtu thyerjen e shtresave të betoneve apo asfalteve, evadimin e materialeve të tepërta jashtë objektit dhe çdo shpenzim tjetër që ka të bëjë me realizimin e punimeve të gërmimit. Të përdoret kalëpi aty ku është i nevojshëm. Ky cmim i referohet 1 m³.